

**L I G J**  
**Nr.9118, datë 24.7.2003**

**PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE TË PAPAGUARA TË KONTRIBUTEVE TË  
SIGURIMEVE SHOQËRORE**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 9227, datë 29.4.2004)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Neni 1

*(Shtuar paragraf me ligjin nr. 9227, datë 29.4.2004)*

Falen kamatëvonesat e kontributeve për sigurimet shoqërore të papaguara deri në datën 31.12.2002 nga ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital tërësisht shtetëror, nga ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital të përbashkët me shtetin, nga personat juridikë e fizikë privatë dhe nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, me kusht që detyrimet për kontributet të arkëtohen brenda datës 31 dhjetor 2004.

Kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet shoqërore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2

Pushohet ekzekutimi i vendimeve të gjykatave, që kanë marrë formë të prerë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për pjesën e kamatëvonesave të sigurimeve shoqërore të papaguara, të cilat falen me këtë ligj.

Neni 3

Kamatëvonesat e kontributeve për sigurimet shoqërore, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk rikthehen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3944, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**